



KOMISIONI
EVROPIAN

Bruksel, më 24.7.2020
COM(2020) 608 versioni përfundimtar

**KOMUNIKATA E KOMISIONIT DREJTUAR PARLAMENTIT EVROPIAN,
KËSHILLIT, KOMITETIT EVROPIAN EKONOMIK DHE SOCIAL DHE
KOMITETIT TË RAJONEVE**

Plani i Veprimit i BE-së 2020-2025 për trafikimin e jashtëligjshëm të armëve të zjarrit

Plani i Veprimit i BE-së 2020-2025 për trafikimin e armëve të zjarrit

Tabela e përmbajtjes

1.	HYRJE	2
2.	PROBLEMATIKA.....	3
3.	NISMAT E BE-SË.....	6
4.	NJË PLAN I RI VEPRIMI I BE-SË 2020-2025	8
4.1.	Përcaktimi i treguesve dhe raportimi.....	8
4.2.	Prioritetet gjithëpërfshirëse	9
4.2.1.	Prioriteti 1: Ruajtja e tregut të ligjshëm dhe kufizimi i devijimit	9
4.2.2.	Prioriteti 2: Krijimi i një kuadri më të mirë për inteligjencën.....	10
4.2.3.	Prioriteti 3: Rritja e presioni mbi tregjet kriminale	11
4.2.4.	Prioriteti 4: Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar	12
5.	VEPRIMET SPECIFIKE PËR EVROPËN JUGLINDORE DHE BASHKËPUNIMI I SAJ ME BE-NË.....	13
5.1.	Përshtatja e aktiviteteve me rajonin.....	13
5.2.	Një qeverisje e modernizuar për të garantuar një zbatim efikas	14
5.2.1.	Përbushja e nevojave për financim për trajtimin e sfidave	14
5.2.2.	Një udhëheqje gjithëpërfshirëse për zbatimin e aktiviteteve në Evropën Juglindore.....	15
6.	PËRFUNDIME	16

1. HYRJE

Në fillim të korrikut të vitit 2020, Europol, Franca dhe Holanda shpallën rezultatet e një hetimi të gjerë e të përbashkët ndërkufitar kundër një rrjeti kriminal madhor, i cili rezultoi në konfiskimin e dhjetëra armëve automatike të zjarrit në Holandë. Gjatë trazirave në Dijon (Francë) në fund të qershorit, një grup të rinjsh u shfaq duke ekspozuar me krenari armë gjysmëautomatike dhe pistoleta, në video të filmuara nga vetë ata. Paralelisht me këtë, një operacion policor në Spanjë ekspozoi një rrjet të gjerë të trafikimit të armëve të zjarrit, me konfiskimin e 730 armëve dhe me 21 arrestime në mbarë vendin. Këta janë shembuj të cilët dëshmojnë kërcënimin real që paraqesin armët e jashtëligjshme të zjarrit. Aktivistët e së djathtës ekstreme po vihen gjithnjë e më shumë në qendër të vëmendjes për grumbullim të armëve. Kjo tregon se si armët e zjarrit mund të rrisin rrezikun që paraqet krimi i rëndë dhe i organizuar, përfshirë edhe terrorizmin. Sipas llogaritjeve, numri i armëve të jashtëligjshme të zjarrit të zotëruara nga civilët në BE në vitin 2017 ka qenë 35 milionë (56% e numrit total të përlogaritur të armëve të zjarrit).¹ Bazuar në këto përlogaritje, numri i armëve të jashtëligjshme të zjarrit do të tejkalonte atë të armëve të zjarrit të mbajtura ligjërisht në dymbëdhjetë shtete anëtare të BE-së.²

Si një zonë pa kufij të brendshëm, BE-ja ka luajtur një rol aktiv në luftën kundër këtij kërcënimi. Ajo ka fuqizuar dukshëm legjislacionin për armët e zjarrit për të shmangur rënien e armëve në duar të gabuara.³ Organizatat kriminale që veprojnë në BE i sigurojnë armët e zjarrit kryesisht përmes konvertimit të jashtëligjshëm të armëve jo vdekjeprurëse dhe përmes trafikimit: qoftë me anë të transferimeve të jashtëligjshme midis shteteve anëtare të BE-së apo nëpërmjet futjes kontrabandë nga vende jashtë Bashkimit Evropian (kryesisht nga Evropa Juglindore).⁴ Gjatë viteve të fundit, BE-ja ka mbështetur zhvillimin e një koordinimi të konsoliduar ndërmjet organeve ligjzbatuese në këtë fushë.

Megjithatë, mbeten ende një sërë sfidash dhe nevojitet një grup i ri masash për t'u bërë ballë këtyre sfidave, siç u konstatua në veçanti edhe nga Vlerësimi i Komisionit lidhur me planin e veprimit 2015-2019 për trafikimin e armëve të zjarrit midis BE-së dhe rajonit të Evropës Juglindore".⁵ Bashkimi Evropian dhe partnerët e tij, veçanërisht ata të Evropës Juglindore, duhet të përballen me këto sfida duke e trajtuar trafikimin e armëve të zjarrit si një çështje prioritare sigurie me karakter ndërsektorial. Për hir të natyrës gjithëpërfshirëse dhe shumëdisiplinore të kërcënimit, vetëm një plan i unifikuar veprimi mund arrijë të sigurojë një kuadër koherent bashkëpunimi për të intensifikuar bashkëpunimin ndërkombëtar sipas nevojave, kërkesave dhe treguesve specifikë të performancës.

¹ Small Arms Survey, "Estimating Global Civilian-held Firearms Numbers", Dokument Përmbledhës, qershor 2018. Grupi i të dhënave disponohet në http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/Weapons_and_Markets/Tools/Firearms_holdings/SAS-BP-Civilian-held-firearms-annexe.pdf

² HU, IT, BE, AT, LT, LV, FR, DE, SI, PL, RO, NL.

³ Shih shtojcën 1 për informacion të mëtejshëm.

⁴ Për qëllimin e këtij plani veprimi, të gjithë partnerët e Ballkanit Perëndimor, Moldavia dhe Ukraina do të konsiderohen pjesë e "Evropës Juglindore".

⁵ COM(2019) 293 final, 27.06.2019.

Për rrjedhojë, Komisioni propozon një plan unik veprimi për BE-në dhe partnerët e Evropës Juglindore (Ballkani Perëndimor, Moldavia dhe Ukraina), të fokusuar në katër prioritetet specifike për trajtimin e boshllëqeve dhe mospërputhjeve të mbetura ligjore në kontrollin e armëve të zjarrit, të cilat përbëjnë pengesë për bashkëpunimin policor. Ky plan veprimi do të përcaktojë aktivitete që mundësojnë një perceptim dhe vizion të përbashkët mbi mënyrën e trajtimit të kërcënimit të armëve të jashtëligjshme të zjarrit.

2. PROBLEMATIKA

Në vitin 2019, Europoli konstatoi se përfundimet e Vlerësimit të tij të Kërcënimeve nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar (SOCTA), të kryer në vitin 2017, mbeten ende të vlefshme, dhe se përhapja dhe disponueshmëria e armëve të jashtëligjshme të zjarrit në shtetet anëtare të BE-së rrisin rrezikun e përdorimit të tyre në sulme terroriste dhe nga krimi i organizuar. Megjithatë, Europoli theksoi se “ndryshimet që kanë pësuar *modus operandi*, rrugët dhe zonat gjeografike të prekura nga aktivitete të caktuara kriminale mund të jenë tregues të disa zhvillimeve dhe ndryshimeve më afatgjata lidhur me kriminalitetin”. Trafikimi, shpërndarja dhe përdorimi i jashtëligjshëm i armëve të zjarrit "mbeten një kërcënim madhor". Në veçanti, "shitjet e armëve të çaktivizuara, të riaktivizuara dhe të konvertuara kanë pësuar rritje."⁶ Armët e jashtëligjshme të zjarrit janë më lehtësisht të aksesueshme në internet, veçanërisht në rrjetin e errët (dark web), dhe krahas grupeve të krimit të organizuar, tregtimi i tyre po kryhet gjithnjë e më shpesh edhe nga kriminelë individë. Armët e jashtëligjshme të zjarrit konsistojnë më së shumti në pistoleta dhe pushkë (përkatesisht 34% dhe 27% e armëve të konfiskuara).

Një studim i kryer së fundmi⁷ identifikoi 23 incidente të vrasjeve në masë që kanë ndodhur në hapësira (gjysmë)publike në Evropë gjatë harkut kohor 2009-2018 dhe kanë shkaktuar 341 viktima. Në vitin 2015, Europoli regjistroi 57 akte terroriste që përfshinin përdorimin e një arme zjarri.⁸ Në vitin 2017, 41% e të gjitha sulmeve terroriste përfshinin përdorimin e armëve të zjarrit, duke regjistruar kështu një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2016 (38%).⁹ Rasti i fundit studimor i Eurojust konfirmon se ka pasur një sërë rastesh të përdorimit të armëve të zjarrit në sulme terroriste dhe se rrjetet e trafikimit kanë ndërvepruar me individë terroristë apo me organizata terroriste. Koordinimi i hetimeve ndërkufitare nga Eurojust ka rezultuar në disa raste në konfiskimin e armëve të jashtëligjshme të zjarrit.

Këto tendenca janë konfirmuar në vija të përgjithshme nga të dhënat më të fundit të mbledhura nga Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimit (UNODC):¹⁰ gjatë vitit 2016-2017 në BE, 30% e armëve të konfiskuara ishin shotganë, pasuar nga pistoletat (22%), pushkët (15%) dhe revolverët (8%), ndërsa pjesa e mbetur përbëhej kryesisht nga automatikë dhe mitraloza (2%). Në armët e konfiskuara brenda Evropës në tërësi, vihet re një shpërndarje më uniforme midis pistoletave (35%), pushkëve (27%) dhe shotganëve (22%).

⁶ Europol, "Interim report of new, changing and emerging threats", Dokumenti i Këshillit 9037/19, datë 8.5.2019.

⁷ Flemish Peace Institute, *Armed to kill*, Bruksel, 3 tetor 2019.

⁸ Europol, TE-SAT 2017: EU Terrorism and Trend Report.

⁹ Europol, TE-SAT 2018: EU Terrorism and Trend Report.

¹⁰ UNODC (2020), *Global Study on Firearms Trafficking*, Vjenë: UNODC, i disponueshëm në <https://www.unodc.org/unodc/en/firearms-protocol/firearms-study.html>.

Evropa konsiderohet si një prej pikave kryesore të nisjes për qarkullimin e jashtëligjshëm të armëve, por ky qarkullim është përgjithësisht i kufizuar brenda përbrenda kontinentit. Për më tepër, llojet e armëve të konfiskuara përfshijnë një përqindje të konsiderueshme armësh të ndryshme nga ato të zjarrit (si p.sh. armë me fishekë manovër dhe armë me gaz), çka thekson kërcënimin e konvertimit të këtyre armëve në armë të jashtëligjshme zjarri.

Europoli dhe autoritetet ligjzbatuese theksojnë se bandat e jashtëligjshme të motoçiklistëve trafikojnë armë zjarri brenda BE-së. Shumë prej grupeve të krimit të organizuar të përfshira në trafikimin e armëve të zjarrit ushtrojnë një shumëllojshmëri aktivitetimesh kriminale, duke u përfshirë ndër të tjera edhe në trafikun e drogës, krimin e organizuar kundër pronës, kontrabandimin e emigrantëve, pastrimin e parave dhe krimet e dhunshme. Në disa shtete anëtare (si Suedia dhe Danimarka) është spikatur një rritje domethënëse e niveleve të vrasjes dhe krimeve të tjera të dhunshme, shoqëruar me një raportim të rritjes së përdorimit të armëve potencialisht vdekjeprurëse, të tilla si armët e zjarrit, thikat dhe lëndët plasëse. Në Suedi janë numëruar 40 vdekje të shkaktuara me armë në vitin 2017, shifër e cila tregon një rritje me 33,3% krahasuar me vitin pararendës.¹¹

Një sërë raportesh të vlerësimit të kërcënimeve nga Europoli kanë konfirmuar se Ballkani Perëndimor vazhdon të jetë një ndër rajonet kryesore përgjegjëse për trafikun drejt BE-së,¹² duke theksuar nevojën për përmirësim të qarkullimit të informacionit dhe inteligjencës ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Kërcënimi i vazhdueshëm që paraqet ky rajon është konfirmuar nga shumë studime, më i fundit ndër të cilët¹³ thekson se armët e përdorura në sulme terroriste në BE "janë siguruar nëpërmjet tregjeve lokale të armëve të jashtëligjshme të zjarrit dhe kanë rezultuar me origjinë nga Ballkani". I njëjti studim e ka identifikuar Ballkanin "si furnizuesin kryesor të armëve të zjarrit në Evropë" dhe ka përmendur "lidhjen midis Ballkanit dhe armëve të vogla të përdorura në shtetet anëtare të BE-së në lloje të ndryshme aktivitetimesh kriminale." Kjo u konfirmua nga Studimi i fundit Global i UNODC për armët e zjarrit,¹⁴ sipas të cilit Ballkani Perëndimor mbetet një burim i armëve të jashtëligjshme të zjarrit, veçanërisht i pushkëve automatike, për shkak të kontrastit të konsiderueshëm të çmimeve me Evropën Perëndimore.

Bashkëpunimi ndërmjet organeve ligjzbatuese brenda BE-së dhe në nivel ndërkombëtar paraqet një potencial të madh për përmirësim. Ka ende divergjenca midis kuadrove ligjore dhe përkufizimeve në nivel kombëtar, çka përbën pengesë për elaborimin e qasjeve të përbashkëta dhe mund të shfrytëzohet nga kriminelët në favor të tyre. Shtetet anëtare kanë ende shumë punë për të bërë për transpozimin dhe zbatimin e plotë të Direktivës për Armët e Zjarrit.¹⁵ Më 24 korrik 2019, Komisioni dërgoi 20 opinione të arsyetuara për shtetet anëtare

¹¹ Studimi Global i UNODC për Vrasjet, 2019.

¹² Raportet e Europolit: Threat Assessment Report on Illicit Trafficking in Firearms (EDOC#673806v7A, qershor 2013), Intelligence Notification (19/2014); "Firearms in the hands of Terrorist in Europe" (EDOC:#759937v3; maj 2015).

¹³ *Strengthening Resilience in the Western Balkans: Mapping Assistance for SALW Control*, Studimi për Armët e Vogla, shtator 2018.

¹⁴ UNODC (2020), *Global Study on Firearms Trafficking*, Vjenë: UNODC, i disponueshëm në <https://www.unodc.org/unodc/en/firearms-protocol/firearms-study.html>.

¹⁵ Direktiva (BE) 2017/853, datë 17 maj 2017, "Për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 91/477/KEE "Për kontrollin e blerjeve dhe mbajtjen e armëve"", Gazeta Zyrtare L 137, 24.5.2017, f. 22.

që nuk kishin komunikuar ende transpozimin e plotë të direktivës.¹⁶ Gjithashtu, në dhjetor të vitit 2017, Komisioni publikoi një vlerësim të zbatimit të Rregullores (BE) nr. 258/2012 lidhur me importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit për përdorim civil, vlerësim i cili identifikoi boshllëqe të ardhura si pasojë e mungesës së zbatimit të njëtrajtshëm.¹⁷ Kjo u pasua në prill të vitit 2018 nga një Rekomandim përmes të cilit bëhej thirrje për fuqizimin e rregullave të BE-së, me synim përmirësimin e gjurmueshmërisë dhe sigurisë së procedurave të kontrollit të importeve dhe eksporteve të armëve të zjarrit, si dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve në luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit.¹⁸

Pavarësisht përjekjeve, e veçanërisht Studimit Global të UNODC për Armët e Zjarrit, të financuar nga Komisioni, kuadri i inteligjencës mbetet i fragmentuar për shkak të mungesës së të dhënave gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme lidhur me konfiskimet e armëve të zjarrit në mbarë kontinentin. Shkëmbimi i informacionit për qëllime të inteligjencës dhe profilizimit ndeshet me kufizime të vendosura nga legjislacionet kombëtare ndaj shkëmbimit të informacionit (duke përfshirë edhe të dhënat jopersonale, të tilla si të dhënat balistike) përveçse për qëllime të ndonjë hetimi specifik. Problemi përshkallëzohet edhe më tej nga mungesa e komunikimit dhe koordinimit ndërmjet administratave të ndryshme, brenda shteteve dhe në nivel transkombëtar. 20 shtete anëtare të BE-së¹⁹ dhe 4 partnerë të Ballkanit Perëndimor²⁰ kanë vënë në dispozicion një formë të caktuar Njësie Qendrore për Armët e Zjarrit. Megjithatë, këto njësi janë shpeshherë të pa pajisura me kompetencat e duhura (për kontrollin administrativ, mbledhjen e të dhënave për qëllime ligjzbatuese, aksesin në bazat e të dhënave, gjurmimin, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe kriminalistikën) dhe me personelin e duhur sipas rekomandimeve të dhëna nga ekspertë kombëtarë të armëve të zjarrit në udhëzimet e tyre të bazuara te praktikatat më të mira.²¹

Për më tepër, kriminalizimi i trafikimit të armëve të zjarrit është i paunifikuar: jo çdo transferim ndërkufitar i paautorizuar i armëve kualifikohet si trafikim, gjë që bie ndesh me Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit.²² Ndonjëherë, kjo rezulton në mungesën e masave ndëshkimore dhe sanksioneve. Gjithashtu pengon konfiskimin e produkteve të veprës penale të përfutuara me anë të trafikimit të armëve të zjarrit. Qasjet kombëtare divergjente përbëjnë pengesë për operacionet e përbashkëta ndërkufitare, si për shembull dërgesat e kontrolluara.

¹⁶ Më 15 prill 2020, 17 shtete anëtare kishin komunikuar transpozimin e plotë (AT, BG, DE, DK, IE, EL, EE, FR, HR, IT, LV, LT, MT, NL, PT, RO, FI).

¹⁷ COM(2017) 737 final, 12.12.2017.

¹⁸ C(2018) 2197 final, 17.4.2018.

¹⁹ Bullgaria, Qiproja, Estonia, Irlanda, Letonia, Lituania dhe Malta nuk kanë asnjë Njësie Qendrore.

²⁰ Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina nuk kanë asnjë Njësie Qendrore.

²¹ "Best practice guidance for the creation of national firearms focal points", 15.5.2018, Dokumenti i Këshillit N. 8586/18.

²² Protokollin e datës 31 maj 2001 kundër Prodhimit të Jashtëligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve, Komponentëve dhe Municioneve të tyre, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar. Vendimi i Këshillit, datë 11 shkurt 2014, "Për miratimin, në emër të Bashkimit Evropian, të Protokollit kundër Prodhimit të Jashtëligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve, Komponentëve dhe Municioneve të tyre, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar"; Gazeta Zyrtare L89, datë 25.3.2014, f.7.

Veçanërisht në Evropën Juglindore, ka ende punë për të bërë për të siguruar pajtueshmërinë e administratave kombëtare me standardet më të larta dhe për të garantuar kontrollin efikas të armëve të zjarrit. Nevojat variojnë nga ngritja e bazave kombëtare të të dhënave dhe e kapaciteteve balistike e deri te sigurimi i stoqeve dhe organizimi i fushatave për dorëzimin vullnetar të armëve. Për sa i përket qeverisjes, në raportin e vlerësimit të planit të veprimit 2015-2019, Komisioni theksoi "vështirësinë e bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe rajonit të Evropës Juglindore për shkak të ekzistencës së një sërë aktorësh, të cilët nuk janë gjithmonë të koordinuar", një "dublikim të panevojshëm të mbledhjeve" dhe "mungesën e një qasjeje buxhetore të integruar dhe gjithëpërfshirëse në nivel BE-je".

Tendenca të reja po shfaqen gjithashtu në BE dhe mes fqinjëve evropianë, të cilët përballen shpeshherë me sfida të ngjashme. Këto tendenca përfshijnë ndryshime në teknikat e konvertimit për shndërrimin në armë zjarri të armëve me fishekë manovër ose armëve me gaz apo atyre alarmuese, si dhe metoda të reja fshehjeje. Kriminelët përpiqen gjithashtu t'i shmangen ligjit duke ndërruar tytat e armëve lehtësisht të disponueshme të kalibrit Flobert (armë me kalibër të vogël dhe fuqi të ulët, të synuara për qitje "në sallon"). Risetë teknologjike në printimin 3D mund të lehtësojnë prodhimin e jashtëligjshëm të armëve të zjarrit në të ardhmen. Dita-ditës po zbulohen tendenca të reja shpërndarjeje, duke përfshirë trafikimin e armëve të zjarrit përmes postës së shpejtë dhe shërbimit postar, gjë që ka rezultuar në një kalim të dukshëm nga eksporti i armëve tradicionale të konflikteve nga Ballkani Perëndimor tek importi i armëve të reja nga Evropa Perëndimore drejt Ballkanit, apo importi i komponentëve kryesorë të pamarkuara nga Shtetet e Bashkuara. Konfliktet e armatosura në territoret e fqinjëve lindorë të BE-së krijojnë gjithashtu burime potenciale të sigurimit të armëve të jashtëligjshme për BE-në.

Konfliktet e armatosura të tejzgjatura me pasoja të gjera rajonale në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut (MENA) vazhdojnë të nxiten nga devijimi dhe trafikimi i armëve të zjarrit. Trafiku i armëve të zjarrit në këtë rajon lehtësohet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë stoqet e pasiguruara dhe devijimin e armëve të ligjshme të zjarrit, duke përfshirë edhe ato të prodhuara ligjërisht dhe të eksportuara rregullisht nga shtetet anëtare të BE-së. Në Afrikë, trafikimi i armëve të zjarrit kontribuon në paqëndrueshmërinë e rajonit.

3. NISMAT E BE-SË²³

Trafikimi i armëve të zjarrit është identifikuar prej kohësh nga BE-ja si një kërcënim madhor për qytetarët. Kjo e ka shtyrë Komisionin të përvijojë një politikë të posaçme për trajtimin e kësaj problematike përmes Komunikatës së vitit 2013 për Armët e Zjarrit²⁴ dhe Axhendës Evropiane për Sigurinë të vitit 2015.²⁵ Në vitin 2014, plani i parë operacional i veprimit për kriminalitetin u hartua nga shtetet anëtare si pjesë e **Platformës Evropiane Shumëdisiplinore kundër Kërcënimeve Kriminale** (EMPACT Firearms) në kuadrin e Ciklit të Politikave të BE-së 2014-2018, nën seksionin për "Armët e zjarrit".²⁶

²³ Shih shtojcën 1 për më shumë hollësi.

²⁴ Komunikata e Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin Evropian "Për armët e zjarrit dhe sigurinë e brendshme të BE-së: mbrojtja e qytetarëve dhe ndërprerja e trafikimit të jashtëligjshëm", COM (2013) 716, datë 21.10.2013.

²⁵ Komunikata e Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, COM (2015) 185 final i datës 28.4.2015.

²⁶ Doc. 16726/3/13 RISH. 3 RESTREINT UE/I KUFIZUAR NGA BE.

Që prej vitit 2002, BE-ja ka ofruar asistencë për Ballkanin Perëndimor me anë të një sërë Vendimesh të njëpasnjëshme CFSP të Këshillit për dhënien e financimeve për projekte që lidhen me kontrollin e armëve të vogla, në një vlerë totale prej përafërsisht 30 milionë Euro. Aktivitetet e mbuluara kanë përfshirë një sërë fushash, duke kontribuar në përmirësimin e kontrollit të armëve të vogla dhe në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të armëve. I fundit ndër këto Vendime CFSP të Këshillit, i cili parashikon financim në një shumë të paprecedentë prej 11,8 milionë Euro, u propozua nga Përfaqësuesi i Lartë dhe u miratua nga Këshilli në dhjetor 2019, për një kohëzgjatje prej 4 vitesh. Partneri kryesor zbatues i BE-së për asistencën e ofruar për rajonin ka qenë Zyra Qendrore në Evropën Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC²⁷). Ajo ka zbatuar një qasje rajonale gjithëpërfshirëse ndaj kontrollit të armëve të zjarrit në rajon, duke përfshirë përmirësimin e markimit, gjurmimit dhe mbajtjes së inventarëve; përmirësimin e aktiviteteve ligjzbatuese; rritjen e sigurisë fizike dhe përmirësimin e menaxhimit të stoqeve; rritjen e ndërgjegjësimit dhe politikat gjinore, si dhe transparencën e eksportit të armëve. Kjo mbështetje e qëndrueshme dhe afatgjatë për Ballkanin Perëndimor ka kontribuar në krijimin e besimit mes autoriteteve kombëtare të rajonit dhe ka ndihmuar në përmirësimin e bashkëpunimit rajonal.

Në vitin 2014, BE-ja dhe partnerët e saj të Ballkanit Perëndimor miratuan një **plan veprimi për trafikimin e jashtëligjshëm të armëve të zjarrit mes BE-së dhe rajonit të Evropës Juglindore** për periudhën 2015-2019.²⁸ Në nëntor të vitit 2015, në vijim të sulmeve terroriste në Paris, Komisioni propozoi fuqizimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor të BE-së për të plotësuar disa boshllëqe, gjë që rezultoi në rishikimin e Direktivës për Armët e Zjarrit. Paralelisht me këtë, Komisioni publikoi “**Planin e ri të veprimit të BE-së kundër trafikimit dhe përdorimit të jashtëligjshëm të armëve të zjarrit dhe lëndëve plasëse**”.²⁹

Në vitin 2018, Komunikata e Përbashkët e Këshillit dhe e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë për “**Elementet drejt një Strategjie të BE-së kundër Armëve të Jashtëligjshme të Zjarrit, Armëve të Vogla dhe të Lehta dhe Municioneve të tyre**”³⁰ u miratua nga Këshilli, duke u shndërruar në një strategji të mirëfilltë në nivel BE-je.³¹

Gatishmëria e autoriteteve të Ballkanit Perëndimor për të trajtuar bashkërisht boshllëqet e mbetura me anë të një qasjeje rajonale është artikuluar së fundmi përmes hartimit të Udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e jashtëligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e AVL-ve dhe municioneve të tyre (referuar në vijim si Udhërrëfyesi Rajonal³²), të miratuar në Samitin e Londrës të mbajtur në kuadër të Procesit të Berlinit më 10

²⁷ SEESAC është një nismë e përbashkët e UNDP-së dhe e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, e themeluar në vitin 2002.

²⁸ 14 nëntor 2014, Dokumenti i Këshillit 15516/14, miratuar nga Këshilli i datës 4 dhe 5 dhjetor 2014 (Dokumenti i Këshillit 16526/14); BE – Forumi Ministror i Ballkanit Perëndimor për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme, datë 12 dhjetor 2014, në Beograd.

²⁹ COM(2015) 624, versioni përfundimtar i datës 2.12.2015.

³⁰ JOIN(2018) 17 final, 1.6.2018.

³¹ Përfundimet e Këshillit, datë 19 nëntor 2018 – Dokumenti 13581/18.

³² Udhërrëfyesi u hartua me mbështetjen e SEESAC nga autoritetet e Ballkanit Perëndimor, përmes një procesi konsultimi. Ai u miratua në Samitin e Londrës të mbajtur në kuadër të Procesit të Berlinit më 10 korrik 2018 nga krezët e shteteve dhe të qeverive të Ballkanit Perëndimor.

korrik 2018. Kjo nismë mori më pas mbështetje financiare nga BE-ja me anë të Vendimit të Këshillit të datës 19 nëntor 2018.³³

Veprimet e ndërmarra midis BE-së dhe vendeve të treta në fushën e aspekteve ligjzbatuese të luftës kundër trafikimit të armëve të zjarrit janë realizuar kryesisht në kuadër të "EMPACT Firearms". Ato janë fokusuar në zhvillimin e kapaciteteve kombëtare kundër trafikimit të armëve të zjarrit, në zhvillimin e shkëmbimit operacional të informacionit me shtetet anëtare dhe Europolin dhe në zhvillimin e operacioneve të përbashkëta të kontrollit.

Komisioni, përmes Fondit për Sigurinë e Brendshme - Policia, ka promovuar dhe mbështetur financiarisht një sërë studimesh, siç janë programet kërkimore EFFECT,³⁴ FIRE³⁵ dhe SAFTE³⁶, për të përmirësuar njohuritë mbi trafikimin e jashtëligjshëm të armëve të zjarrit, duke përfshirë ndër të tjera edhe trafikimin në internet dhe devijimin e tregtisë së ligjshme. Komisioni ka financuar Programin Global të UNODC për Armët e Zjarrit për mbledhjen dhe analizimin e informacionit dhe të dhënave sasiore dhe cilësore për trafikimin e armëve të zjarrit.³⁷

Me anë të Instrumentit kontribuues në Qëndrueshmëri dhe Paqe (IcSP), Komisioni ka financuar gjithashtu punën e Programit Global të UNODC për Armët e Zjarrit në drejtim të zbatimit të Konventës së OKB-së kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar dhe të Protokollit të saj për Armët e Zjarrit në shtetet partnere. INTERPOL ka marrë gjithashtu mbështetje financiare për krijimin dhe zhvillimin e Sistemit të tij për Menaxhimin e Regjistrimit dhe Gjurmimit të Armëve të Jashtëligjshme (iARMS).

Komisioni dhe Këshilli kanë ofruar mbështetje edhe për mbledhjen vullnetare të armëve të jashtëligjshme të zjarrit, shkatërrimin e armëve dhe municioneve të tepërta, sigurinë fizike dhe menaxhimin e stokeve, zhvillimin e kapaciteteve të markimit, mbajtjes së inventarëve dhe gjurmimit dhe zhvillimin e kapaciteteve për kontrollin e eksportit të armëve, si dhe për monitorimin e embargove dhe gjurmimin e armëve të devijuara.

4. NJË PLAN I RI VEPRIMI I BE-SË 2020-2025

4.1. Përcaktimi i treguesve dhe raportimi

Planet e mëparshme të veprimit nuk përfshinin **tregues** të përshtatshëm, gjë që e ka ndërlikuar vlerësimin e zbatimit të tyre. Në vitin 2018, partnerët e Ballkanit Perëndimor dhe disa shtete anëtare të BE-së zhvilluan tregues të dobishëm në kuadër të Udhërrëfyesit Rajonal. Zhvilluar

³³ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2018/1788, datë 19 nëntor 2018, "Për mbështetjen e Zyrës Qendrore në Evropën Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) në zbatimin e Udhërrëfyesit Rajonal për luftën kundër trafikimit të jashtëligjshëm të armëve në Ballkanin Perëndimor", Gazeta Zyrtare L 293, 20.11.2018, f.11.

³⁴ *Examination of Firearms and Forensics in Europe and across Territories*, ed. Professor Erica Bowen and Dr Helen Poole, Coventry University, Calabria University, Arquebus Solutions Ltd, 2016.

³⁵ *Fighting Illicit Firearms Trafficking Routes and Actors at European Level*, eds. Ernesto U. Savona, Marina Mancuso, Transcrime – Università Cattolica del Sacro Cuore, 31.3.2017.

³⁶ *Triggering Terror: Illicit Gun Markets and Firearms Acquisition of Terrorist Networks in Europe*, ed. Nils Duquet, Flemish Peace institute, 17 prill 2018.

³⁷ UNODC (2020), *Global Study on Firearms Trafficking*, Vjenë: UNODC, i disponueshëm në <https://www.unodc.org/unodc/en/firearms-protocol/firearms-study.html>.

nga autoritetet e Ballkanit Perëndimor me mbështetjen e SEESAC, këta tregues u lavdëruan nga të gjitha grupet e përfshira të interesit.

Komisioni propozon që të përdoren tregues të ngjashëm për të vlerësuar dhe monitoruar efikasitetin e planit të ri të veprimit për luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit, me grumbullim sistematik të të dhënave mbi kriminalitetin dhe drejtësinë penale nga agjencitë ligjzbatuese (policia, doganat, prokurorët dhe shërbimet gjyqësore). Ndër të tjera, këta tregues përfshijnë pajtueshmërinë me legjislacionin e BE-së, numrin e konfiskimeve, numrin e ndjekjeve penale dhe dënimeve për trafikimin e armëve të zjarrit, numrin e licencave të eksportit dhe verifikimeve pas transportit, numrin e Njësive Qendrore të ngritura për Armët e Zjarrit, numrin e armëve të dorëzuara, të legalizuara, të çaktivizuara apo të shkatërruara (shih shtojcën 4 për më shumë hollësi). Treguesit përkatës janë përmendur përkatësisht në vijim pas çdo veprimi.

Çdo vit, Komisioni Evropian do t'u kërkojë shteteve anëtare të BE-së dhe partnerëve të Evropës Juglindore, në pajtim me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2018/1788, që të sigurojnë të dhëna lidhur me treguesit e performancës, shoqëruar sipas rastit me prova konkrete (si për shembull në lidhje me shkatërrimin e armëve), në mënyrë që të merret një vlerësim i përditësuar i aktiviteteve vjetore. Komisioni do të mbështesë autoritetet kompetente duke zhvilluar metodologjinë dhe udhëzimet e qarta për këtë raportim, në bashkëpunim të ngushtë me "EMPACT Firearms":

4.2. Prioritetet gjithëpërfshirëse

4.2.1. Prioriteti 1: Ruajtja e tregut të ligjshëm dhe kufizimi i devijimit

Komisioni Evropian do të thellojë më tej angazhimin e tij për të garantuar që **Direktiva për Armët e Zjarrit** dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese përkatëse të transpozohen saktë dhe të vihen në zbatim në mënyrë efikase nga të gjitha shtetet anëtare. Ai do të vazhdojë të ushtrojë të gjitha kompetencat që i janë akorduar nga Traktati për këtë qëllim. Zbatimi i Direktivës për Armët e Zjarrit nga shtetet anëtare përbën prioritet. Komisioni inkurajon partnerët e Evropës Juglindore të përafrojnë plotësisht legjislacionin e tyre për kontrollin ligjor me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. **[Veprimi 1.1 – KPI 1]** Për të asistuar shtetet anëtare dhe partnerët e Evropës Juglindore, Komisioni do të zhvillojë së bashku me Europolin një tabelë referencë për armët e zjarrit në nivel BE-je, që mundëson klasifikimin e thjeshtë të armëve të zjarrit sipas kategorive të BE-së. **[Veprimi 1.2]**

Sipas kërkesave të Direktivës për Armët e Zjarrit, Komisioni do të publikojë një raport mbi zbatimin e saj në fillim të vitit 2021. Në këtë mënyrë, ai do të shqyrtojë mënyrat sesi mund të trajtohen më së miri **kërcënimet e reja dhe ato të ardhshme**, veçanërisht ato që lidhen me armët e zjarrit "Flobert" dhe printimin 3D të armëve të zjarrit. **[Veprimi 1.3]**

Komisioni do të kryejë një vlerësim të ndikimit mbi legjislacionin e BE-së **për kontrollet e importit dhe eksportit të armëve të zjarrit për përdorim civil**, **[Veprimi 1.4 – KPI 6]**, veçanërisht për të gjetur mënyra për të përmirësuar gjurmueshmërinë (markimet e harmonizuara në import), për të shkëmbyer informacione midis autoriteteve kombëtare për të shmangur shkeljen e ndalimeve të eksportit, si dhe për të rritur sigurinë e procedurave të kontrollit të eksportit dhe importit të armëve të zjarrit (procedurat e thjeshtuara janë më të qarta). Ai do të shqyrtojë mënyra sesi mund të garantohet pajtueshmëria ndërmjet Rregullores nr. 258/2012 dhe Direktivës për Armët e Zjarrit, p.sh. për të trajtuar më mirë importet e armëve alarmuese dhe sinjalizuese lehtësisht të konvertueshme ose për të kryer kontrole të eksportit mbi të gjitha armët që gjejnë rregullim në direktivë. Për të garantuar zbatimin e plotë të rregullave të tij, Komisioni synon gjithashtu të vërë në zbatim regjimin e mbrojtjes së

sinjalizuesve, të krijuar nga Direktiva (BE) nr. 2019/1937³⁸, për personat që raportojnë shkelje të Rregullores nr. 258/2012, të ndryshuar.

Së fundi, për të nxitur zbatimin e konventave ndërkombëtare përkatëse të OKB-së,³⁹ Komisioni do të fuqizojë kapacitetet e vendeve partnere për të ushtruar kontrolle efikase të armëve të zjarrit dhe do të thellojë angazhimin e tij **për t'u pajtuar me standardet më të larta**, në mënyrë që të garantojë gjurmimin efikas dhe të shmangë devijimin e armëve të zjarrit drejt tregjeve të jashtëligjshme. **[Veprimi 1.5 – KPI 1]**

4.2.2. *Prioriteti 2: Krijimi i një kuadri më të mirë për inteligjencën*

Komisioni rithekson rekomandimin e tij që shtetet anëtare **ta furnizojnë sistematikisht Sistemin e Informacionit të Schengen** me informacione rreth armëve të zjarrit të humbura dhe të vjedhura, si dhe rreth armëve të shitura që mund të konvertohen lehtësisht në armë zjarri, dhe **të konsultohen me këtë sistem** kur konfiskojnë një armë. **[Veprimi 2.1 – KPI 9.8]** Komisioni do të ofrojë mbështetjen e tij për nismat që u mundësojnë autoriteteve kombëtare të kryejnë kërkime dhe/ose regjistrime të njëkohshme të të dhënave si në Sistemin e Informacionit të Schengen ashtu dhe në sistemin iARMS të INTERPOLIT, dhe nxit shtetet anëtare t'i përgjigjen thirrjes së INTERPOLIT për vullnetare për testimin e funksioneve të reja. **[Veprimi 2.2 – KPI 9.6]** Është me rëndësi thelbësore që çdo informacion operacional dhe strategjik që lidhet me inteligjencën dhe rrezikun dhe që është me rëndësi për doganat të kalojë automatikisht te Sistemi i përbashkët për Menaxhimin e Rreziqeve në Dogana (CRMS). **[Veprimi 2.3 – KPI 9.9]** Shtetet anëtare dhe partnerët e Evropës Juglindore duhet të regjistrojnë sistematikisht në iARMS të gjitha armët e zjarrit të humbura dhe të vjedhura. **[Veprimi 2.4 - KPI 9.6]**

Duke u bazuar te përvojat e projektit të zbatuar nga UNODC, Komisioni do të ndërmarrë veprime për të mundësuar një **grumbullim sistematik dhe të harmonizuar të të dhënave mbi konfiskimet e armëve të zjarrit**, **[Veprimi 2.5 – KPI 4]** dhe do të publikojë statistika vjetore, siç është vepruar për analizimin e konfiskimeve të drogës.⁴⁰ Kjo do të sigurojë informacion të dobishëm për autoritetet ligjzbatuese, veçanërisht për t'i ndihmuar ato të identifikojnë tendencat e reja të trafikimit dhe të krijojnë profile më të sakta rreziku. Me synimin për të realizuar këtë, dhe duke u bazuar në punën përgatitore të kryer nga aktorë të ndryshëm, të tillë si Europol, Frontex, UNODC, EMPACT Firearms dhe partnerët e Evropës Juglindore, Komisioni do të propozojë një formular të përbashkët të raportimit të konfiskimeve. Komisioni, në bashkëpunim me Europolin, do të shqyrtojë realizueshmërinë e vënies në përdorim në nivel BE-je të një mjeti për gjurmimin në kohë reale **të incidenteve që përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit** dhe për krijimin e një kuadri në përditësim të vazhdueshëm. **[Veprimi 2.6 – KPI 10]** Për këtë, ai do të bazohet në projektin FIRE të vitit

³⁸ Direktiva (BE) nr. 2019/1937 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2019, "Për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të legjislacionit të BE-së", Gazeta Zyrtare e datës 26.11.2019, L 305/17.

³⁹ Shih shtojcën 1.

⁴⁰ Nenet 5 dhe 5a të Rregullores (KE) nr. 1920/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, "Për Qendrën Evropiane të Monitorimit të Drogave dhe të Varësisë nga Droga"; Gazeta Zyrtare L 376, 27.12.2006.

2017, të financuar nga BE-ja⁴¹, si dhe në Platformën e Monitorimit të Dhunës me Armë që mbulon Evropën Juglindore.⁴²

Trafikimi i armëve të zjarrit mund të kryhet edhe përmes platformave të tregtimit në rrjetin e errët (dark web). Komisioni do të vërë në zbatim veprimin paraprak të propozuar nga Parlamenti Evropian për monitorimin 24-orësh të "darknet". **[Veprimi 2.7]** Gjithashtu, në kuadër të Ciklit të Politikave të BE-së, Europoli do të vazhdojë të asistojë shtetet anëtare në mbledhjen e informacionit dhe krijimin e një kuadri të sigurt të inteligjencës për përdorimin e darknet-it për tregtimin e jashtëligjshëm të armëve të zjarrit.

4.2.3. Prioriteti 3: Rritja e presioni mbi tregjet kriminale

Komisioni i nxit shtetet anëtare dhe partnerët e Evropës Juglindore të përfundojnë ngritjen e **Njësive Qendrore për Armët e Zjarrit** në çdo juridiksion dhe pajisjen e tyre me personelin dhe trajnimin e duhur, sipas rekomandimeve të dhëna nga ekspertët kombëtarë në udhëzimet e tyre të bazuara te praktikat më të mira.⁴³ **[Veprimi 3.1 – KPI 7.1]** Këto njësi qendrore duhet të jenë sistematikisht të lidhura me zbatimin e Programit të Veprimit të OKB-së për Armët e Vogla dhe të Lehta dhe Instrumentit Ndërkombëtar të Gjurmimit. Për të lehtësuar bashkëpunimin në nivel BE-je dhe në nivel ndërkombëtar, Komisioni do të publikojë një listë të këtyre njësive qendrore, duke përcaktuar qartë të dhënat e kontaktit dhe kompetencat e secilës. **[Veprimi 3.2 – KPI 7.1]**

Komisioni u bën thirrje të gjitha shteteve anëtare që nuk e kanë bërë ende këtë⁴⁴ të ratifikojnë **Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit**, i cili thjeshtëson dhe fuqizon bashkëpunimin me synim parandalimin, çrënjosjen dhe luftën kundër prodhimit të jashtëligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit. **[Veprimi 3.3 – KPI 1.5]** Komisioni do të nisë gjithashtu një konsultim me grupet e interesit për të shqyrtuar nëse ka ende boshllëqe në kuadrin legjislativ dhe për të vlerësuar nevojën për përcaktimin e **standardeve të përbashkëta të legjislacionit penal për trafikimin e armëve të zjarrit** dhe prodhimin e jashtëligjshëm të tyre, në përputhje me nenin 83 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian. **[Veprimi 3.4 – KPI 1.5 & 8]** Në këtë drejtim, Komisioni do të shqyrtojë realizueshmërinë e rregullave që mundësojnë bashkëpunimin policor për të garantuar një gjurmim më sistematik të armëve të konfiskuara, për të shkëmbyer inteligjencë jashtë kuadrit të hetimeve specifike, për të ndarë të dhëna balistike më lehtë dhe më sistematikisht, ose për të kryer dërgesa të kontrolluara.

Komisioni fton shtetet anëtare dhe partnerët e Evropës Juglindore të **përmirësojnë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të tyre ligjzbatuese (doganave, policisë dhe rojave kufitare), por edhe ndërmjet prokurorëve dhe specialistëve të kriminalistikës**, si dhe të bllokojnë burimet dhe rrugët kryesore të trafikimit të armëve të jashtëligjshme të zjarrit, duke

⁴¹ *Fighting Illicit Firearms Trafficking Routes and Actors at European Level*, op. cit.

⁴² <http://www.seesac.org/AVMP> Vendimi për financimin: Vendimi i Këshillit (CFSP) 2019/2111, datë 9 dhjetor 2019, "Për mbështetjen e veprimtarive të SEESAC për çarmatimin dhe kontrollin e armëve në Evropën Juglindore në reduktimin e kërcënimit të armëve të vogla dhe të lehta të jashtëligjshme dhe municioneve të tyre", Gazeta Zyrtare L 318, 10.12.2019.

⁴³ Shih më lart shënimin 21 në fund të faqes.

⁴⁴ Gjermania, Irlanda, Luksemburgu, Malta. Të gjithë partnerët e Evropës Juglindore e kanë ratifikuar Protokollin ose kanë aderuar në të.

u frymëzuar nga Rrjeti i Ekspertëve të Evropës Juglindore për Armët e Zjarrit [**Veprimi 3.5 – KPI 3**] Ata duhet të thellojnë në shkallë të konsiderueshme ekspertizën e autoriteteve të tyre ligjzbatuese lidhur me kërcënimin e armëve të zjarrit, kuadrin ligjor dhe mjetin e bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht duke i shfrytëzuar më mirë mundësitë për trajnim të ofruara nga CEPOL, dhe duke zhvilluar trajnime të njëpasnjëshme për të rritur vlerën e shtuar. [**Veprimi 3.6 – KPI 7.2**]

Komisioni fton Europolin, shtetet anëtare dhe Evropën Juglindore të fokusohen te çështjet që lidhen me armët e zjarrit në kuadrin e operacioneve të patrullimit kibernetik dhe masave kundër **platformave të tregtimit në dark web**, duke siguruar koordinimin e Ditës së Përbashkët të Veprimit për Patrullimin Kibernetik (Cyber Patrol Joint Action Day) dhe hetimet e dark web-it në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e dedikuar të Europolit për dark web-in. [**Veprimi 3.7 – KPI 9.4**]

Komisioni do të përmirësojë gjithashtu **bashkëpunimin ndërmjet agjencive ligjzbatuese dhe operatorëve të postës të shpejtë dhe asaj të zakonshme**, për të garantuar një mbikëqyrje më të rreptë të dërgesave që përmbajnë armë zjarri apo komponentë të tyre. Ai do të shqyrtojë në veçanti shkallën në të cilën intelijenca artificiale mund të përdoret për të identifikuar më mirë pjesët e armëve të fshehura mes ngarkesave të vogla, veçanërisht përmes skanimit me rreze X. [**Veprimi 3.8**] Gjithashtu, ai do të propozojë një memorandum mirëkuptimi në nivel BE-je ndërmjet operatorëve të postës së shpejtë dhe autoriteteve policore dhe doganore, për të përmirësuar komunikimin e të dhënave lidhur me armët e zjarrit dhe pjesët e armëve të zjarrit dhe mënyrën sesi ata mbështesin njëri-tjetrin, duke u bazuar në praktikatat më të mira të zbatuara më parë në nivelin kombëtar. [**Veprimi 3.9**] Kjo do të garantojë kushte të barabarta duke shmangur transferimin e operatorëve në vende me kontrolle më të dobëta.

4.2.4. Prioriteti 4: Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe vendeve të treta partnere duhet të thellohet në përputhje me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e BE-së të vitit 2018 kundër Armëve të Jashtëligjshme të Zjarrit, Armëve të Vogla dhe të Lehta dhe Municioneve të tyre.⁴⁵

Thellimi i bashkëpunimit me vendet e Afrikës së Veriut dhe Lindjes së Mesme është me rëndësi të veçantë.

Bashkëpunimi me Tunizinë, Libanin dhe Jordaninë duhet të thellohet në aspektin e gjurmimit të armëve dhe përmirësimit të kontrolleve të armëve. Komisioni do të bashkëpunojë ngushtë me Përfaqësuesin e Lartë dhe u bën thirrje shteteve anëtare të angazhojnë një numër më të madh personeli të asistencës teknike në vendet e Afrikës së Jugut dhe Lindjes së Mesme. [**Veprimi 4.1**] Duke qenë se konsiderohet si vend origjine për sasi të mëdha armësh me gaz dhe armësh alarmuese lehtësisht të konvertueshme, e për rrjedhojë të jashtëligjshme, Turqia duhet të jetë gjithashtu në qendër të vëmendjes për bashkëpunim. [**Veprimi 4.2**]. Në **Afrikë**, dhe veçanërisht në rajonin e Sahelit, do të inkurajohet rritja e sigurisë fizike dhe përmirësimi i menaxhimit të stoqeve, mbajtjes së inventarëve dhe kontrollit të armëve. [**Veprimi 4.3**] Shkëmbimet e praktikave të mira me Evropën Juglindore janë tashmë në proces e sipër.

Duke pasur parasysh rrezikun e lartë të trafikimit të armëve të zjarrit në **Evropën Juglindore** (e cila konsiderohet se përfshin vendet e treta partnere të Ballkanit Perëndimor, Ukrainën dhe

⁴⁵ Shih më lart shënimin 30 në fund të faqes.

Moldavinë), specifikat që lidhen me kontekstin e saj gjeo-politik, numrin e madh dhe llojin e aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë të përfshirë, si dhe paqëndrueshmërinë aktuale të rajonit të Evropës Lindore, Raporti i Vlerësimit të planit të veprimit 2015-2019 ka nxjerrë në pah nevojën për një plan të ri veprimi. Ky i fundit është rekomanduar edhe nga delegatët e partnerëve pjesëmarrës në mbledhjen e tretë të Komitetit të Përbashkët mes Ekspertëve të BE-së për Armët e Zjarrit dhe Ekspertëve të Evropës Juglindore, e cila u mbajt në Bruksel më 24 shtator 2018. Raporti i vlerësimit theksoi gjithashtu nevojën për përfshirjen e Ukrainës dhe Moldavisë në një kuadër më të gjerë e koherent bashkëpunimi kundër kërcënimeve të përbashkëta që paraqet trafikimi i jashtëligjshëm i armëve të zjarrit për mbarë rajonin. Kjo vjen gjithashtu në përgjigje të thirrjes së Këshillit për përfshirjen e Ukrainës në planet operationale përkatëse të veprimit në kuadër të Ciklit të Politikave të BE-së kundër krimin ndërkombëtar të organizuar.⁴⁶ Për sa i përket Ukrainës, Plani i Veprimit do të marrë në konsideratë mbështetjen e BE-së⁴⁷ për përpjekjet e Ukrainës në luftën kundër trafikimit të jashtëligjshëm të armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse, në bashkëpunim me OSCE dhe SEESAC.⁴⁸ Komisioni mbështet me fonde të BE-së menaxhimin e integruar të kufijve dhe aktivitetet e anti-trafikimit, ndër të tjera edhe përmes Misionit Evropian të Asistencës Kufitare për Moldavinë dhe Ukrainën. Puna e "Conflict Armament Research" në Ukrainë, e mbështetur nga Vendimi i Këshillit (CFSP) 2017/2283 është ende në proces.

Për rrjedhojë, si pjesë e këtij Plani Veprimi, Komisioni propozon veprime të detajuara dhe qeverisje specifike për Evropën Juglindore (shih seksionin 5 më poshtë), që do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me Përfaqësuesin e Lartë dhe në konsultim me partnerët.

5. VEPRIMET SPECIFIKE PËR EVROPËN JUGLINDORE DHE BASHKËPUNIMI I SAJ ME BE-NË

5.1. Përshtatja e aktiviteteve me rajonin

Siç përmendet në seksionin 2, vlerësimi i planit të veprimit 2015-2019 BE-Evropë Juglindore⁴⁹ ka dëshmuar se të dyja përballen me sfida të përbashkëta, dhe se thellimi i bashkëpunimit rajonal është thelbësor për të trajtuar më mirë dimensionin transkombëtar të trafikimit të jashtëligjshëm të armëve të zjarrit në rajon.

Puna e kryer në vitin 2018 për hartimin e Udhërrëfyesit Rajonal, me mbështetjen e Francës dhe Gjermanisë, rezultoi nga një qasje konsensuale dhe përfshirëse e të gjithë partnerëve të Ballkanit Perëndimor. Ajo identifikoi një sërë objektivash dhe qëllimesh përkatëse, të cilat do të ishte e përshtatshme të përfshiheshin në një plan veprimi. Mbi bazën e kësaj, Komisioni propozon në shtojcën 3 një grup aktivitetesh specifike të cilat integrojnë Udhërrëfyesin në planin e veprimit, në përputhje me Vendimin e Këshillit për financimin e zbatimit të tij.⁵⁰

⁴⁶ Konkluzionet e Këshillit për fuqizimin e bashkëpunimit BE-Ukrainë lidhur me sigurinë e brendshme. Dok.15615/17, datë 11.12.2017.

⁴⁷ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2019/2009, datë 2 dhjetor 2019, "Për mbështetjen e përpjekjeve të Ukrainës në luftën kundër trafikimit të jashtëligjshëm të armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse, në bashkëpunim me OSCE"; *Gazeta Zyrtare L 312*, 3.12.2019, f. 42.

⁴⁸ Shih Vendimet e Këshillit (CFSP) 2018/1788, (CFSP) 2019/2111 dhe (CFSP) 2019/2113, për dhënien e mbështetjes për Moldavinë, Bjellorusinë dhe Ukrainën.

⁴⁹ Shih më lart shënimin 5 në fund të faqes.

⁵⁰ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2018/1788, datë 19 nëntor 2018, "Për mbështetjen e Zyrës Qendrore në Evropën Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) në zbatimin e

Të gjitha juridiksionet në rajon përballen me sfida të ngjashme. Megjithatë, jo të gjithë partnerët do t'i arrijnë objektivat e tyre me të njëjtin ritëm, dhe nivelet e ndryshme të progresit do të diktojnë domosdo edhe ambicie të ndryshme. Në të njëjtën kohë, këto veprime duhet të përfshijnë në mënyrën e duhur edhe Ukrainën dhe Moldavinë. Komisioni, në bashkëpunim me Përfaqësuesin e Lartë, do të angazhohet me këto dy vende për të diskutuar mjete dhe mënyra për t'i integruar ato në kuadrin e përgjithshëm.

Këto veprime specifike për rajonin e Evropës Juglindore janë përcaktuar nga autoritetet e Ballkanit Perëndimor përmes hartimit dhe miratimit të Udhërrëfyesit Rajonal, bashkëngjitur Vendimit të Këshillit (CFSP) 1788/2018. Duke ndjekur objektivin gjithëpërfshirës të Planit të Veprimit, konkretisht luftën kundër trafikimit të jashtëligjshëm të armëve të zjarrit dhe municioneve, ky udhërrëfyes fokusohet në tri pika kryesore, duke garantuar më shumë qartësi dhe një strukturim më të mirë krahasuar me Planin e Veprimit 2015-2019, veçanërisht me synimin për të trajtuar boshllëqet dhe papajtueshmëritë ligjore të mbetura në lidhje kontrollin e armëve të zjarrit, të cilat përbëjnë pengesë për bashkëpunimin policor dhe gjyqësor:

- Harmonizimi i kuadrit ligjor, duke modernizuar strukturën administrative dhe duke lehtësuar ngritjen e kapaciteteve;
- Sigurimi më i mirë i stoqeve dhe reduktimi i tyre;
- Rritja e efikasitetit të veprimtarive ligjzbatuese përmes lehtësimit të bashkëpunimit operacional, shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit për analiza balistike.

5.2. Një qeverisje e modernizuar për të garantuar një zbatim efikas

Për një realizim të plotë të këtyre aktiviteteve, të gjithë partnerët duhet të nxjerrin mësim nga e shkuara, veçanërisht duke krijuar një lloj të ri qeverisjeje që shmang mbivendosjet apo mungesën e koordinimit.

5.2.1. Përmbushja e nevojave për financim për trajtimin e sfidave

Komisioni merr përsipër të thellojë më tej angazhimin e tij me partnerët e Evropës Juglindore dhe të alokojë burime financiare të dedikuara për t'i ndihmuar ata të arrijnë standardet e kërkuara. Krahas shumës prej 11,8 milionë Euro të ofruar në dhjetor 2019 nga Këshilli⁵¹, Komisioni synon të mobilizojë dhe alokojë mjetet e disponueshme të Fondit për Sigurinë e Brendshme dhe të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit për përballjen me sfidat më urgjente. Në kuadrin e negociatave të kuadrit financiar shumëvjeçar, Komisioni u bën thirrje shteteve anëtare që t'u përgjigjen nevojave duke rënë dakord mbi zgjidhje buxhetore ambicioze dhe duke mobilizuar ekspertët e tyre në terren.

Komisioni, së bashku me Përfaqësuesin e Lartë, do të thërrasë një **komitet drejtues të partnerëve zbatues dhe donatorëve kryesore**, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shteteve anëtare, Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm, Agjencive përkatëse të Kombeve të Bashkuara (UNDP dhe UNODC) dhe NATO-s. Ambicia e këtij komiteti drejtues do të jetë garantimi i koordinimit strategjik global të donatorëve, duke përfshirë edhe ata që nuk janë pjesë e bordit drejtues të Fondit të Besimit Shumëpalësh të Kombeve të Bashkuara për

Udhërrëfyesit Rajonal për luftën kundër trafikimit të jashtëligjshëm të armëve në Ballkanin Perëndimor", Gazeta Zyrtare L 293, 20.11.2018, f.11.

⁵¹ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2019/2111, datë 9 dhjetor 2019, "Për mbështetjen e veprimtarive të SEESAC për çarmatimin dhe kontrollin e armëve në Evropën Juglindore në reduktimin e kërcënimit të armëve të vogla dhe të lehta të jashtëligjshme dhe municioneve të tyre", Gazeta Zyrtare L 318, 10.12.2019.

zbatimin e Udhërrëfyesit. Përmes dialogut me qeveritë në rajon, Komisioni do të propozojë një memorandum mirëkuptimi midis këtyre pjesëmarrësve, me synim marrjen e vendimeve të përbashkëta lidhur me projektet që do të financohen. Në respektim të plotë të autonomisë ligjore të donatorëve, dhe në përputhje të plotë me procedurat vendimmarrëse përkatëse në bazë të traktateve, ky memorandum mund të përcaktojë mënyrën sesi komiteti do të zhvillojë një planifikim buxhetor rajonal dhe kombëtar dhe do të marrë raportime financiare të konsoliduara lidhur me çdo aktivitet dhe instrument. Kjo do t'u sigurojë të gjithë donatorëve dhe grupeve të interesit një panoramë gjithëpërfshirëse dhe të përditësuar të aktiviteteve të planifikuara ose të vëna në zbatim, si dhe të kostos të tyre. Për të garantuar sinergjinë e përpjekjeve dhe koordinimin efikas me SEESAC, do të përmirësohet koordinimi i donatorëve në nivelin lokal dhe do të garantohet një funksion koordinues, veçanërisht duke caktuar një koordinator rajonal për armët e zjarrit, i cili duhet të jetë i punësuar pranë një prej delegacioneve të BE-së në Evropën Juglindore, siç është delegacioni i BE-së në Beograd.

5.2.2. Një udhëheqje gjithëpërfshirëse për zbatimin e aktiviteteve në Evropën Juglindore

Komisioni propozon bashkërendimin e punës së organeve ekzistuese për përmirësimin e koordinimit. Udhëheqja politike do të vazhdojë të jepet nga Këshilli i BE-së dhe nga komitetet e ministrave të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme dhe, sipas rastit, të Punëve të Jashtme, si dhe nga komitete të tjera ministrore mes BE-së dhe partnerëve të Evropës Juglindore.

Për të garantuar udhëheqjen strategjike të aktiviteteve, mbledhjet mes organeve kombëtare ndërministrare dhe institucioneve përgjegjëse për kontrollin e armëve të vogla (komisionet për armët e vogla) duhet të vazhdojnë të kryhen në praninë e përfaqësuesve të BE-së. Tashmë është kthyer në praktikë organizimi i mbledhjeve koordinuese lidhur me udhërrëfyesin së bashku me ta, për të lehtësuar shqyrtimin e progresit në zbatimin e udhërrëfyesit me anë të shkëmbimit të mësimave të nxjerra dhe diskutimeve lidhur me plotësimin e boshllëqeve të mbetura.

Në nivelin e aktiviteteve rajonale ligjzbatuese, do të ishte gjithashtu me vend një bashkërendim i të gjitha organeve ekzistuese.⁵² Komisioni sugjeron zhvillimin e mbledhjeve të përbashkëta mes ekspertëve të BE-së dhe atyre të Evropës Juglindore në kuadrin e "EMPACT Firearms", ku janë ftuar të marrin pjesë edhe partnerët e Ballkanit Perëndimor.

Në të gjitha nivelet, Komisioni u bën thirrje autoriteteve të dërgojnë pjesëmarrës të cilëve u është besuar kompetenca për të paraqitur qëndrime dhe për të marrë përsipër angazhime apo për të dhënë kontribut lidhur me rezultatet e mundshme.

Së fundi, për sa i përket menaxhimit administrativ, që prej vitit 2002, SEESAC ka lehtësuar ndjeshëm proceset e komisioneve për armët e vogla dhe të rrjetit të ekspertëve të Evropës Juglindore për armët e zjarrit, si dhe koordinimin e Udhërrëfyesit Rajonal. Ai ka ofruar asistencë të konsiderueshme teknike për partnerët në rajon, duke marrë lëvdata nga të gjitha grupet e interesit të pranishme në terren. Ky proces pritet të vazhdojë, në përputhje me Vendimet e Këshillit të BE-së (CFSP) 2013/710, 2016/2356, 2018/1788 dhe 2019/2111, në një frymë transparence lidhur me menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit përmes komitetit

⁵² Ekspertët Evropianë të Armëve të Zjarrit, "EMPACT Firearms", Rrjeti i Ekspertëve të Evropës Juglindore për Armët e Zjarrit dhe Grupi i tij i Ekspertëve të Evropës Juglindore për Armët e Zjarrit, Komiteti i Përbashkët i ekspertëve të armëve të zjarrit nga BE-ja dhe partnerët e Ballkanit Perëndimor.

drejtues të donatorëve. Më konkretisht, programet e mbledhjeve, dokumentet buxhetore dhe raportet duhet të paraqiten në përputhje me qasjen e integruar, pas konsultimit me Komisionin.

Komisioni i jep një rëndësi të madhe udhëheqjes dhe mbështetjes së partnerëve në realizimin e angazhimeve të ndryshme dhe përdorimit të treguesve për matjen e rezultateve, si p.sh. me anë të raportimit 6-mujor pranë SEESAC lidhur me progresin e zbatimit të Udhërrëfyesit Rajonal dhe vlerësimit të planifikuar afatmesëm të zbatimit të Udhërrëfyesit Rajonal sipas Vendimit të Këshillit (CFSP) 2018/1788. Për rrjedhojë, ai do të shfrytëzojë në maksimum procesin e anëtarësimit për të diskutuar dhe monitoruar hapat e ndërmarrë në lidhje me zbatimin e planit të veprimit. Kjo nënkupton se mbledhjet e Nënkomiteteve të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme dhe raportet kombëtare vjetore do të përdoren për vlerësimin e progresit të arritur. Negociatat e anëtarësimit në Kreun 24 - Drejtësia, liria dhe siguria, do të shfrytëzohen për të kontribuar në arritjen e objektivave të planit të veprimit. Për sa u përket vendeve që nuk janë të përfshira në planin për zgjerim, diskutimet për përditësim lidhur me progresin do të zhvillohen në kuadrin e Nënkomiteteve të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme, Platformave të Shtetit të së Drejtës apo forumeve të tjera ekzistuese.

6. PËRFUNDIME

Lufta kundër aksesit të jashtëligjshëm në armët e zjarrit duhet të trajtohet si një çështje prioritare sigurie me karakter ndërsektorial për Bashkimin Evropian, shtetet e tij anëtare dhe partnerët e tij. Ky akses i jashtëligjshëm është një burim pasigurie fizike për individët dhe rrit rrezikun e dhunës në familje, e cila mund të përshkallëzohet deri në vrasje ose mund të rezultojë në përdorimin e armëve të zjarrit për të kryer vetëvrasje. Lufta kundër këtij fenomeni kontribuon edhe në trajtimin e formave të tjera të veprimtarive kriminale, të tilla si terrorizmi, trafikimi i drogave të jashtëligjshme, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabandimi i emigrantëve, pirateria detare, kontrabanda, krimet kundër mjedisit ose krimi i organizuar kundër pronës. Komisioni i bën thirrje Parlamentit Evropian, Këshillit, shteteve anëtare dhe partnerëve të Evropës Juglindore për të njohur plotësisht nevojën e intensifikimit të veprimeve në këtë fushë në nivel kombëtar, në nivel BE-je dhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar.

Komisioni ka bindjen se karakteri gjithëpërfshirës dhe shumëdisiplinor i këtij plani veprimi mund të sigurojë një kuadër operacional koherent për BE-në dhe shtetet e saj anëtare brenda kufijve të BE-së, si dhe propozon bashkëpunim dhe asistencë në luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit brenda Evropës Juglindore dhe midis saj dhe BE-së.

Komisioni i bën thirrje veçanërisht institucioneve të BE-së, autoriteteve ligjzbatuese dhe grupeve të interesit, si brenda BE-së ashtu dhe në Evropën Juglindore, që të trajtojnë sfidat e përmendura në këtë plan veprimi. Komisioni fton Parlamentin Evropian dhe Këshillin të miratojnë këtë Plan Veprimi dhe të mbështesin e të shfrytëzojnë potencialin e plotë të çdo prioriteti strategjik.